



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

**VENDIM**

Nr. 259, datë 10.12.2024

**PËR**

**“CAKTIM TË PËRKOHSHËM”**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me pjesëmarrjen e:

<b>1. Zonjës Mirela BOGDANI</b>	<b>Kryetar</b>
<b>2. Zotit Sokol STOJANI</b>	<b>Anëtar</b>
<b>3. Zotit Zeqir HODA</b>	<b>Anëtar</b>
<b>4. Zonjës Arta MANDRO</b>	<b>Anëtar</b>
<b>5. Zonjës Ledina RIZA</b>	<b>Anëtar</b>
<b>6. Zotit Moisi DUDA</b>	<b>Anëtar</b>
<b>7. Zotit Vatë STAKA</b>	<b>Anëtar</b>
<b>8. Zotit Olger EMINAJ</b>	<b>Anëtar</b>
<b>9. Zotit Erind GËRMENJI</b>	<b>Anëtar</b>
<b>10. Zotit Erind MERKURI</b>	<b>Anëtar</b>
<b>11. Zoti Erion Fejzulla</b>	<b>Anëtar</b>

në mbledhjen e datës 10.12.2024, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 59 pika 1 dhe 4, të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, Rregulloren “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve” e ndryshuar, shqyrtoi çështjen me objekt:

**“Caktim të përkohshëm”**

**BAZA LIGJORE:**

1. Neni 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;



2. Neni 59 pika 1 dhe 4, të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
3. Nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar;
4. Rregullore “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve” e ndryshuar.

### KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë nga:

- i. Relacioni shpjegues i përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës nr. 2660 prot., datë 06.12.2024;
- ii. Projektvendimi i formatuar;

si dhe referuar bazës ligjore të lartpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,

### V Ë R E N:

1. Me vendimin Nr. 332, datë 19.12.2022, “Për shpalljen e pesë vendeve vakante për procedurën e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë shpalli 5 vende vakante në këtë zyrë prokurorie, të cilat do të plotësoheshin nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele.
2. Njëri ndër vendet e shpallura ishte pozicioni vakant Nr.4 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ku u kualifikuan 4 kandidatë. Në përfundim të procedurës, me vendimin nr.96, datë 09.05.2023, “Për renditjen e kandidatëve për pozicionin vakant Nr. 4 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka renditur kandidatët si më poshtë:
  1. *Platin Aliçka*
  2. *Xhelian Seferi*
  3. *Edlira Bako*
  4. *Aida Cakaj*
3. Ndërkohë, Këshilli i Lartë i Prokurorisë me vendimin nr. 125, datë 29.05.2023 “Për caktimin e zotit *Platin Aliçka* në detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele”, ka bërë caktimin në detyrë të prokurorit të renditur i pari referuar nenit 41, pika 2 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.
4. Vendimi i Këshillit nr.96, datë 09.05.2023, “Për renditjen e kandidatëve për pozicionin vakant Nr. 4 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të





*Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë*” është bërë objekt ankimi nga ana e kandidatës së renditur në vend të tretë, zonzës Bako duke pretenduar llogaritjen e eksperiencës së saj të komandimit në Ministrinë e Drejtësisë si vjetërsi si magjistratë dhe jo si juriste.

5. Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. 33 (86-2023-663), ka detyruar Këshillin të shfuqizojë vendimin Nr.96, datë 09.05.2023 *“Për renditjen e kandidatëve për pozicionin vakant nr.4 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”*.
6. Në këto kushte, Këshilli i Lartë i Prokurorisë me vendimin nr. 20, datë 07.03.2024, *“Për shfuqizimin e Vendimeve nr. 96, datë 09.05.2023 dhe nr. 125, datë 29.05.2023”*, ka shfuqizuar këto dy vendime dhe me vendimin nr. 21, datë 07.03.2024, ka caktuar përkohësisht zotin Platin Aliçka në detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
7. Më tej, Këshilli ka vijuar me vendimet nr. 72, datë 10.06.2024, dhe nr.191 datë 09.09.2024, të caktojë përkohësisht për një afat tre mujor zotin Platin Aliçka në detyrën e prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
8. Ndërkohë për shkak të Rekursit të ushtruar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë kjo çështje është gjykuar nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në datë 18.09.2024, i cili ka vendosur *“Ndryshimin e vendimit me nr. 33, datë 13.06.2023 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe rrëzimin e padisë së ankueses Edlira Bako”*. Aktualisht ky vendim nuk është zbardhur i arsyetuar nga Gjykata.

**Për sa më sipër, Këshilli i Lartë i Prokurorisë konstaton se:**

9. Meqenëse afati i caktimit të përkohshëm të prokurorit Aliçka përfundon më datë 09.09.2024, si dhe duke marrë në konsideratë se, zoti Platin Aliçka ushtron që në muajin qershor 2023, detyrën si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me qëllim vijueshmërinë dhe garantimin e mbarëvajtjes së punës në trajtimin e çështjeve që aktualisht ky prokuror ka në proces, duhet të caktohet përkohësisht për një periudhë tre mujore, nga data 10.12.2024 – 09.03.2025, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

**PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 59 pika 1 dhe 4, të ligjit Nr.96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”* i ndryshuar, nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”* i ndryshuar, Rregulloren *“Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve”* e ndryshuar, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

## V E N D O S I:

1. Zoti Platin Aliçka, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, të caktohet përkohësisht prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
2. Zoti Platin Aliçka do të ushtrojë funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, nga data 10.12.2024 - 09.03.2025.
3. Të njoftohen për këtë vendim prokurori Platin Aliçka, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 10.12.2024.



**KRYETAR**  
Mirëla Bogdani

**ANËTAR**  
Zeqir Hoda

**ANËTAR**  
Moisi Duda

**ANËTAR**  
Erind Gërmenji

**ANËTAR**  
Arta Mandro

**ANËTAR**  
Vatë Staka

**ANËTAR**  
Erind Merkuri

**ANËTAR**  
Sokol Stojani

**ANËTAR**  
Ledina Riza

**ANËTAR**  
Olger Eminaj

**ANËTAR**  
Erion Fejzulla